



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.98/17

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D..., me seli në Selanik-Greqi, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati B.J. nga Prishtina, kundër të paditurës T... me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati N.S. nga Prishtina, lidhur me pagesën e borxhit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.379/13, të datës 06/02/2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **03/02/2020**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses D..., me seli në Selanik-Greqi dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.379/13, të datës 06/02/2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin ankimor III.EK.nr.379/13, të datës 06/02/2017, në piken I të dispozitivit ka vendosur të refuzon në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses D... me seli në Selanik-Greqi, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura T... me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të borxhit, t'ia paguaj shumën prej 114,429.43 euro si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afat kohor prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa në piken II të dispozitivit të aktgjykimit, ka vendosur që secila palë do ti bartë shpenzimet e procedurës kontestimore veç e veç.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

E paditura ka dhënë përgjigje në ankesë, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta refuzon ankesën e paditëses si të pabazuar dhe ta vërtetoj aktgjykimin e atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 505.1 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e paditëses është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja-kreditorja D... me seli në Selanik-Greqi, me datën 24/04/2009, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur propozim për caktimin e përmbarimit, kundër të paditurës-debitorit T... me seli në Prishtinë, me kërkesë që në emër të shërbimeve për transportin e mallrave, t'ia paguaj kreditorit shumë prej 78.213.41 euro si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Ish Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, me aktvendimin E.nr.84/19 e ka lejuar përmbarimin. Debitori në afatin ligjor ka paraqitur prapsim kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit dhe me këtë rast procedura përmbarimore është shndërrua në kontest të rregullt civil.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë çështje juridike ka mbajtur seancën kryesore me datën 21/04/2010 dhe i autorizuari i paditëses ka deklaruar se qarkullimi i tërësishëm në mes palëve ndërgjyqëse ka qenë në shumë totale prej 519.574.24 euro dhe ka mbetur e pa paguar shuma prej 39.290.72 euro dhe shuma prej 16,320.00 \$, mandej ka theksuar se në seancën e radhës do të bëjë precizimin e kërkesëpadisë, ashtu që gjykata e shkallës së parë, në këtë seancë ka marr aktvendim procedural, me të cilën e ka obliguar paditësen, që në afat prej 10 ditësh të bëjë përkthimin e provave në gjuhën shqipe dhe të bëjë precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë, duke e paralajmëruar paditësen për pasojat juridike.

I autorizuari i paditëses ka vepruar pjesërisht sipas këtij aktvendimi, ashtu që me datën 04/05/2010 i ka prezantuar provat e përkthyer në gjuhën shqipe, por nuk e ka bërë precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë. E paditura ka prezantuar fletëpagesat e datës 16/08/2007 dhe 03/08/2007, me të cilën pretendon se faturat që janë objekt i kërkesëpadisë janë të përmbushura. Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor, ka marr aktgjykimin I.C.nr.123/10 e datës 09/06/2010, me të cilën e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetim se nga transaksioni bankar i datave 03/08/2007 e 16/08/2007, është vërtetuar se e paditura e ka bërë pagesën paditëses në shumë prej 13,176.90 euro dhe në shumë prej 77,416.98 euro, në të cilat transaksione janë përshkruar faturat që janë objekt i kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, me aktvendimin Ae.nr.106/12 e datës 24/06/2013 e ka aprovuar ankesën dhe e ka prish aktgjykimin e gjykatës së shkalle së parë dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim. Paditësja me parashtresën e datës 05/06/2014 e ka bërë zgjerimin e padis edhe për shumën 39.290.72 euro si dhe për shumën 16,320.00 \$, ndërsa ka mbetur në tërësi pranë padis fillestare për borxhin paraprak në lartësi prej 78,215.41 euro, të cilës parashtresë ia ka bashkangjitur faturat me numër dhe me shkronjën a) dhe b) të cilat fatura nuk kanë qenë objekt i kërkesëpadisë. E paditura me parashtresën e datës 14/01/2015, është thirrur në parashkrimin e kërkesave të paraqitura nga paditësja me rastin e zgjerimit të kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqësve si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses duke arsyetuar se kontestuese në mes palëve ishte fakti se e paditura pretendon se nuk i ka pranuar asnjëherë faturat me shenjen a) dhe b), të paraqitura me zgjerimin e padis me datën 05/06/2014, me tej në arsyetim të aktgjykimit theksohet se ndërgjyqësit nuk kanë qenë në raporte kontraktuale, por të gjitha shërbimet kontestuese i kanë kryer me marrëveshje verbale, ndër të tjerash eksperti ka cek se për kryerjen e shërbimeve të transportit, paditësja D... nga Selaniku, për periudhën e viteve 2006-2008, pa ndonjë marrëveshje apo kontratë të veçantë me shkrim, ka kryer shërbime të transportit të mallit për llogari të ndërmjetësuesit-përfituesit të shërbimeve T... nga Prishtina dhe atë për transportin rrugor dhe hekurudhor dhe se për shërbimet e bëra paditësja ka bërë faturime veçmas në emër të transportit dhe veçmas në emër të ngarkimit, shkarkimit, pritjeve, depozitimeve të mallit etj., këto faturime janë bërë në disa raste në valutën euro dhe në disa raste në valutën dollar amerikane, ndërkaq faturat e transportit janë bërë me numra të faturave, ndërsa për shërbimet plotësuese faturat janë dalluar me shenjën (a) dhe (b). E paditura obligimet kundrejt shërbimeve të pranuar përmes faturave pa shenjën (a) dhe (b) gjegjësisht të transportit të cilat i ka pranuar në mënyrë elektronike i ka përmbush herë pas here mirëpo shlyerja e detyrimeve nuk është bërë sipas shumave konkrete të faturave, po ashtu eksperti në ekspertizën e tij në faqen 16 në mënyrë tabelare dhe gjatë seancës ka sqaruar se faturat pa shenjën (a) dhe (b) barazohen me shumën e pagesës së kryer nga e paditura, ndërsa faturat me shenjën (a) dhe (b) nuk ka mundur të vërtetoj se këto fatura i ka pranuar e paditura, pasi që as në librat kontabël të të paditurës nuk figurojnë dhe krejt në fund eksperti ka konkluduar se nëse merren parasysh të gjitha faturat e specifikuara dhe të paraqitura nga paditësja si në pasqyrat e cekura në ekspertizë si dhe pagesat e specifikuara, rrjedh se obligimi i pa shlyeri të paditurës është 99,217.12 euro, ndërsa në dollarë janë 16,320.00 \$, andaj gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nuk ka prova se faturat me shkronjën

a) dhe b) janë dorëzuar të paditurës ndërsa nuk ka vendosur lidhur me kundërshtimin e të paditurës për parashkrimin e faturave me shkronjën a) dhe b) të kërkuara nga paditësja me zgjerimin e padis të datës 05/06/2014. Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në dispozitat e nenit 143 par.1 të LPK-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marr konform nenit 463 par.2 të LPK-së.

Gjykata Apelit e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses duke gjetur se e njëjta është e pa bazuar. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, por gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur lidhur me kërkesën e të paditurës për parashkrimin e kërkesëpadisë duke mos e zbatuar edhe të drejtën materiale për rastin konkret, të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi i gjykatës së shkallës së parë sipas gjendjes faktike të konstatuar është i drejtë dhe i ligjshëm, por jo në tërësi sipas arsytimit që ka dhënë ajo gjykatë mbi bazën e asaj se faturat nuk janë dorëzuar të paditurës, kjo për faktin se nga konfirmimet e faksit, vërtetohet se faturat e vitit 2007 i janë dorëzuar palës së paditur me datën 19/07/2007 dhe me datën 14/08/2007, e cila provë është në lidhje logjike edhe me e-mailin e datës 13/08/2007 nga i cili rezulton se e paditura ia ka dërguar paditëses disa fatura me shkronjën a) dhe b), ndërsa pas kësaj date nuk ka provë që vërteton se paditësja i ka dërguar faturat tjera të paditurës. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është dashur që të vendos lidhur me prapësimet materiale të paditurës sa i përket parashkrimit të kërkesës së paditëse, për faturat me numër dhe me shkronjën a) dhe b) e që sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit financiar R.B., është vërtetuar se obligimi i të paditurës sipas këtyre faturave arrin shumen e gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë është dashur që kërkesëpadinë e paditëses të refuzoj për shkak të parashkrimit të kërkesës e jo të lëshohet në shqyrtimin e bazueshmërisë së saj, kjo për faktin se borxhi sipas këtyre faturave të konstatuar me ekspertizë financiare është krijuar si vijon: Fatura e fundit për shërbime me shkronjën a) është bërë e arritshme me datën 08/01/2008, Fatura e fundit për shërbime me shkronjën b) është bërë e arritshme me datën 31/01/2008 dhe Faturimi i fundit në dollar është bërë e arritshme me datën 28/03/2008, kurse paditësja këtë borxh e ka kërkuar me anë të zgjerimit të padisë me datën 05/06/2014, që nënkupton se kanë kaluar më tepër se 3 vite nga dita e arritshmeris së kërkesës.

Sipas nenit 374 të LMD-së ligjvënësi ka paraparë: *Kërkesat reciproke të personave shoqëror juridikë nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo livrim malli, punë ose shërbim të kryer.*

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet tjera ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertit financiar R.B., është vërtetuar se paditësja për vitin 2006, 2007, 2008 e ka faturuar të paditurën në shumë prej 510,781.67 euro, të cilën shumë e paditura e ka paguar në tërësi, ndërsa eksperti financiar ka ardhur në përfundim se obligimi i të paditurës me faturat me numër dhe me shkronjë a) dhe b) si dhe obligimi në dollar arrin vlerën e përgjithshme prej 114.429.43 euro, ashtu që në seancën e datës 07/06/2016, eksperti financiar përfundimisht ka deklaruar se nëse eliminohen faturat me shkronjën a) dhe b), rrjedh se faturimi barazohet plotësisht me shumën e pagesës së të paditurës, që d.m.th., se e paditura nuk ka obligime tjera ndaj paditëses.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjyqimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
Ae.nr.98/17, me datës 03/02/2020

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku, d.v